



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 773 / Prot
4

Tiranë, më 12 / 6 / 2019

VENDIM

Nr. 17, datë 12 . 6 . 2019

PËR

PRANIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 773 Prot., datë 15.05.2019, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Kamëz” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesja në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 24.04.2019, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni i disponueshëm në lidhje me:

1. *VKB me të cilin zona e ashtuquajtur “Plepat e Brukës” i është dhënë me qira nga Bashkia Kamëz, subjektit “BIOPRODUKTS” sh.p.k.*
2. *Një kopje të kontratës së dhënies me qira.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankimin nr. 773 Prot., datë 15.05.2019, pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes kontaktoi me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik, duke kërkuar informacion në lidhje me kërkesën në fjalë dhe arsyet e mostrajimit të saj.

Koordinatori i Autoritetit Publik, me anë të emailit datë 16.05.2019, sqaroi se: *“Kërkesa e znj. , nuk figuron e regjistruar pranë protokollit të Bashkisë Kamëz”*.

Në këto kushte, duke qenë se ankuesja ka paraqitur si provë recetën postare nr. 1030, datë 24.04.2019, Zyra e Komisionerit me anë të shkresës nr. 773/1 Prot., datë 16.05.2019, kërkoi informacion nga Posta Shqiptare Sh.A, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, në lidhje me praktikën që ka shoqëruar kërkesën në fjalë.

Me anë të shkresës nr. 780/1 Prot., datë 22.05.2019, administruar me tonën nr. 773/2 Prot., datë 23.05.2019, Drejtorja e Shërbimeve të Postës Shqiptare, sqaroi ndër të tjera se: *“Objekti postar me barcode RR846315538AA është pruar në zyrën postare Kamëz me datë 24.04.2019, drejtuar z. Xhelal Mziu, në adresën Bashkia Kamëz dhe dërgues znj. . Bazuar në sistemin e gjurmimit, më datë 26.04.2019, ky objekt i është dorëzuar në protokollin e Bashkisë Kamëz, znj. ”*.

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, me shkresën nr. 773/3 Prot., datë 28.05.2019, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Në ftesën për pjesëmarrje në procesin e shqyrtimit administrativ, Komisioneri për shkak të kompleksitetit të çështjes, konsideroi të rëndësishme që Autoriteti Publik të përfaqësohej me pjesëmarrjen e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit z. Elvin Doda, znj. Aurora Sopaj dhe punonjësit përgjegjës për administrimin/protokollimin e shkresave.

Seanca Dëgjimore u zhvillua më datë 05.06.2019, me praninë e ankueses znj. nga njëra anë dhe Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në cilësinë e përfaqësuesit të Autoritetit Publik, pajisur me autorizimin nr. 2927/1 prot., nga ana tjetër.

Gjatë seancës, përfaqësuesi i Autoritetit Publik deklaroi se është bërë me dije për ankesën në fjalë nga Zyra e Komisionerit dhe ka trajtuar atë me iniciativën e tij duke përgatitur përgjigjen për t’ja vënë në dispozicion ankueses.

Nga ana e ankueses, me anë të emailit datë 06.06.2019, Zyra e Komisionerit është bërë me dije se: *“Pas zhvillimit të seancës dëgjimore, nga ana e Autoritetit Publik është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar”*.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se, pavarësisht se nga ana e Autoritetit Publik nuk është administruar kërkesa e znj. , kjo kërkesë është trajtuar me iniciativë të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik, pas vënies në dijeni nga Zyra e Komisionerit, duke vendosur në dispozicion të kërkueses informacionin objekt kërkesë.

Në këto kushte, duke qenë se detyrimi për dhënien e informacionit të kërkuar është përmbushur, Komisioneri çmon se nuk ka më arsye për t’u shprehur me vendim urdhërimi për Autoritetin Publik.

Nga ana tjetër, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se kërkesa për informim është marrë nga një prej nëpunëseve të Autoritetit Publik. Ky fakt provohet me shkresën nr. 780/1 Prot., datë 22.05.2019 të Postës Shqiptare Sh.A, ku pasqyrohet gjurmimi i kërkesës dhe fotokopja e librit të dorëzimit të objekteve të porositur, me anë të të cilave vërtetohet se znj. Aurora Sopaj është personi përgjegjës që ka marrë në dorëzim kërkesën por nuk e ka administruar atë nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e protokollit. Kjo e fundit u ftua në seancë dëgjimore për të parashtruar argumentet përkatëse, në cilësinë e përfaqësuesit të Autoritetit Publik, por nuk u paraqit.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nëpunësja e cila ka marrë në dorëzim kërkesën pa vënë në dijeni Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, ka veshur cilësinë e Koordinatorit *ad hoc* për të Drejtën e Informimit. Nga ana tjetër, fakti që ajo nuk e ka administruar atë në regjistrin e protokollit, por me qëllim ka vepruar për të shmangur llogaridhënien institucionale, e cila përbën një nga qëllimet kryesore të së drejtës së informimit, e ngarkon me përgjegjësi në përputhje me shkronjën e) të pikës 2) të nenit 18, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën e) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative', i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Sanksionimin e nëpunëses së Autoritetit Publik, znj. Aurora Sopaj, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
2. Kundër këtij vendimi, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u shpall sot në datë 12.6.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

